



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO
VI
Nr. Br. 944 / 2026 -IN
No. 5
Nr i Fa. 5
Br. Str. 5
No. Pg. 5
Data Datum 06.03.2026
Date 06.03.2026
Prishtinë / Pristina

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME
SPECIJALNA KOMORA VRHOVNOG SUDA - SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT

VERTETIMI MBI DOREZIMIN E DOKUMENTIT	POTVRDA O DOSTAVI DOKUMENTA	ACKNOWLEDGEMENT OF RECEIPT OF A DOCUMENT
--	-----------------------------------	--

Numëri i lëndës: Br. predmeta : Case Number:	C-IV.-22-0150		03.03.2026.
Titulli i dokumentit:	Naziv dokumenta:	Document name:	Datë/Datum/Dated:
Aktgjykim			10.02.2026.

Pala	Stranka	Party	AKP -Prishtinë .
Titulli	sufi	Title	
Data	Datum:	Date	
Nënshkrimi	Potpis:	Signature	

L.MXH .





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2022:108721

Datë: 09.02.2026

Numri i dokumentit: 08445740

C-IV-22-0150

Parashtruesi i kërkesës

Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, Autoriteti i Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore “Vreshtaria”(në likuidim) Fi.696/90.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (aplikim për të marr leje për heqje dorë nga aseti), me gjyqtaren kryesuese Luljeta Maxhuni, Manushe Karaçi dhe Ferki Xhaferi gjyqtar anëtar, me datën 10 shkurt 2026, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET kërkesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në Prishtinë, Autoritetit të Likuidimit për NSH-në “Vreshtaria” dhe jepet pëlqimi Agjencisë të heq dorë nga aseti ngastra nr. P- 71813061-00242-3, me sipërfaqe 1769 m2, zona kadastrale Novak, komuna e Prizrenit, në dobi- pronësi të Autoritetit Publik Komuna Prizrenit, në territorin e të cilin gjendjet ky aset.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me datën 20.05.2022, Agjencia Kosovare e Privatizimit, ka ushtruar kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për të marrë leje nga gjykata për të hequr dorë nga aseti ngastra nr. P- 71813061-00242-3, me sipërfaqe 1769 m2, zona kadastrale Novak, komuna e Prizrenit, e cila është e regjistruar në emër të NSH- Vreshtaria.

Numri i lëndës:

Datë:

Numri i dokumentit:

2022:108721

09.02.2026

08445740



Thekson se, Autoriteti i Likuidimit tash ka shqyrtuar kërkesat e ushtruara në procedurë të likuidimit, dhe kërkesa mbështetet në dispozitën e nenit 18 paragrafi 3, i Ligjit nr. 04/L-034, për AKP-në. Ngastra nr P-71813061-00242-3, me sipërfaqe 1769 m², zona kadastrale Novak, komuna e Prizrenit., është pronë e ndërmarrjes shoqërore Vreshtaria, i cili është rast për heqje dore për faktin se kjo parcelë shfrytëzohet si Rrugë Publike, autoriteti i likuidimit erdhi në përfundim që aseti nuk është në gjendje realizimi fitimprurës dhe tashmë ka marr miratimin nga Bordi i Drejtoreve të Agjencisë për të hequr dorë nga aseti. Përveç kësaj, ne pajtim me nenin 11 të Ligjit nr.2003/11 për Rrugët “ asnjë person juridik ose fizik nuk miratohet kërkesa për bartje të pronësisë në rrugë publike ose një pjesë të rrugës publike. Pas aprovimit të kësaj kërkesë të Autoriteti të Likuidimit nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, atëherë në përputhje me nenin 42 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat të tjera Sendore, i cili specifikon që, në nëse hiqet dore nga pronësia në patundshmëri, atëherë pronësinë në patundshmëri e fiton subjekti publik kompetent në territorin të cilës ndodhet patundshmëria “ pronësia mbi këtë aset të kalojë mbi organin publik kompetent.

Tutje, i ka sqaruar gjykatës se Autoriteti i Likuidimit i ka dërguar kryetarit të komunës e Prizrenit me datën 12.04.2022, kërkesë që të konfirmoj që parcela shfrytëzohet si Rrugë Publike dhe në bazë të përgjegjës së kryetarit të Prizrenit të datës 12.05.2022, është konfirmuar se ky aset shfrytëzohet si Rrugë Publike . Andaj, nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës ta aprovoj kërkesën për heqje dore nga aseti dhe ky aset të kalojë në pronësi, të Autoritetit Publik në territorin ku gjendet ngastra lëndore sipas nenit 42 par2, të Ligjit nr. 03/L-154, për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore.

Kërkesës i ka bashkangjitur: Raporti i Vizitës në Teren të datës 21.04.2022, kopja e njoftimit mbi fillimin e proceduarve të likuidimit dhe emërimin e anëtarëve të Komisionit të Likuidimit të datës 09.08.2014, kopjen e njoftimeve për fillimin e procedurës së likuidimit në Gazetën Kosova, Certifikata me numer P-71813061-00242-3, kopja e planit të datës 09.11.2021, kërkesa për konfirmimin në lidhje me asetin Vreshtaria të datës 12.04.2022, Konfirmimi i Kryetarit të Komunës së Prizrenit të datës 29.04.2002, Memorandumi - Rekomandimi i Autoriteti të Likuidimit për Bordin e Drejtoreve – heqje dorë nga aseti për ngastrën P-71813061-00242-3 të N.sh Vreshtaria dhe vendim i Bordit Drejtoreve të datës 29.03.2024 për të hequr dorë nga aseti.

Arsyetimi ligjor

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës e jep pëlqimin për Agjencinë Kosovare e Privatizimit, Autoritetin e Likuidimit për NSH-në “Vreshtaria ” dhe jepet pëlqimi Agjencisë të heq dorë nga aseti

Numri i lëndës:
Datë:
Numri i dokumentit:



ngastra nr. ngastra nr. P- 71813061-00242-3, me sipërfaqe 1769 m2, zona kadastrale Novak, komuna e Prizrenit, në dobi- pronësi të autoritetit publik Komuna Prizrenit, në territorin e të cilin gjendjet ky aset.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, ka juridiksion për të vendosur në bazë të nenit 5 të Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për Ndërmarrjet apo Korporatat të cilat i nënshtrohen autoritetit administrativ të AKP-së .

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, vlerëson se për rastin konkret Agjencia Kosovare e Privatizimit-Autoriteti i Likuidimit në kërkesën e saj për aprovimin e lejes për të hequr dorë nga aseti ngastra P-71813061-00242-3, me sipërfaqe 1769 m2, zona kadastrale Novak, komuna e Prizrenit, ka caktuar zyrtaret e saj për të vizituar gjendjen faktike në teren lidhur me ngastrën lëndore, ka hartuar një raport me shkrim që është konstatuar se sipas certifikatës së pronës, ngastra 71813061-00242-3, me sipërfaqe 1769 m2 me kulturë bujqësore kullos e klasit 4 - e evidentuar si Rrugë Publike. Raportit ja ka bashkangjitur edhe fotografi për të pasqyruar gjendjen faktike të ngastrës.

Duke pasur parasysh gjendjen faktike të ngastrës -asetit, gjykata pranon qëndrimin e Bordit të AKP-së, se aseti nuk mund të jetë fitimprurës për NSH -në , pasi në gjendje aktuale që është ngastra, AKP nuk do të mund të gjejë ndonjë blerës apo që i njëjti të përdoret për realizim të hyrave në dobi të NSH-së, kështu që në rastin konkret Dhoma Posaçme e Gjykatës Supreme jep pëlqimin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit për heqje dorë nga ky aset, në dobi të autoritetit publik, Komuna e Gjilan.

Me dispozitën e nenit 18, paragrafi 3, të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, është paraparë “Autoriteti i Likuidimit , me leje të Gjykatës, mund të heq dorë apo në mënyra tjera të zgjidh cilindo nga asetet e ndërmarrjes në vijim :3.1 çdo aset problematik apo jo profitabil i cili, sipas mendimit të arsyeshëm të Autoritetit të Likuidimit, nuk është në gjendje të ketë realizim fitimprurës ,3.2 çdo aset që sipas mendimit të arsyeshëm të Autoritetit të Likuidimit nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv nga ana e ndërmarrjes, Autoritetit të Likuidimit apo Gjykatës ”

Me rastin e dhënies së pëlqimit për heqje dorë nga aseti , gjykata vlerësoi se janë përmbushur kriteret që parasheh dispozita e nenit 18, paragrafi 3 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.

Për këtë arsye u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2022:108721
Datë: 09.02.2026
Numri i dokumentit: 08445740

Taksat gjyqësore

Parashtruesi i kërkesës, ka bërë pagesën e taksës gjyqësore dhe nuk caktohen taksa shtesë në këtë procedurë.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.



Luljeta Maxhuni, Gjyqtar Kryesuese

Manushe Karaçi, Gjyqtare anëtare

Ferki Xhaferi, Gjyqtar anëtar

[Handwritten signatures in blue ink]